



# Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar

## Albanian National Olympic Committee

Rr. "Liman Kaba", Parku Olimpik, 1001, Tiranë  
Tel: +355 69 600 3707 Email: [secretary.general@nocalbania.org.al](mailto:secretary.general@nocalbania.org.al) <https://nocalbania.org.al>

### NJOFTIM PËR POZICIONIN

#### “Drejtore Finance”

Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar (KOKSH) është një organizatë sportive Kombëtare e pavarur, themeluar në vitin 1958, pa qëllim fitimi, e organizuar mbi bazën e parimeve të Kartës Olimpike, dhe që funksionon sipas statutit të saj. KOKSH është organizata e vetme që përfaqëson Lëvizjen Olimpik Shqiptare, parimet e së cilës janë të detyrueshme për tu zbatuar nga të gjithë anëtarët e saj.

KOKSH fton kandidatët e interesuar për të aplikuar për pozicionin e punës “Drejtore Finance”.

#### Detyrat e Drejtore/ës të Financës

Drejtori/ja i/e financës administron gjithë zinxhirin e procesit financiar të organizatës, që nga inventarizimi i të gjithë asetëve, mirëmbajtja, administrimi, listepagesat, blerjet, planifikimin e shpenzimeve, vlerave monetare etj.

Për të përmbushur objektivat e caktuara Drejtore/ja e/i Financës duhet të kryejë detyrat si më poshtë:

- Meaxhon aspektin financiar të KOKSH në tërësi, duke përfshirë gjithë projektet e zbatuar nga institucioni, dhe kryen gjithë veprimet e nevojshme për të përmbushur detyrimet sipas legjislacionit shqiptar;
- Mbajtja e të dhënave të sakta mbi transaksionet e kryera;
- Proceson fatura, kontrollon faturat e blerjeve, rregjistron depozitat dhe pagesat bankare. regjistron faturat e blerjeve, arka, banka etj;
- Deleton detyra tek specialisti/ët i finances dhe monitoron punën e tij/saj;
- Mban marrëdhënie me Thesarin e Shtetit, Ministrinë e Financave etj;
- Ëton tek drejtori i Sekretari i Përgjithshëm dhe punon ngushtësisht me drejtorët e drejtorive;
- Përgatit ëtet financiare sipas akteve ligjore në fuqi, statutit dhe rregullores së KOKSH.
- Mbikëqyr rrjedhën e parasë dhe instrumentat financiarë, duke bërë edhe pagesat përkatëse sipas datave të caktuara.
- Bën deklaratimet mujore në Institucionin e Tatimeve dhe në Inspektoriatin e punës sipas përcaktimeve ligjore.
- Planifikon, drejton dhe koordinon aktivitetet financiare të punonjësve në zyra dhe departamente.
- Cdo detyrë tjetër që i përshtatet pozicionit të punës apo që i caktohet nga epërori direkt.



# Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar

## Albanian National Olympic Committee

Rr. "Liman Kaba", Parku Olimpik, 1001, Tiranë  
Tel: +355 69 600 3707 Email: [secretary.general@nocalbania.org.al](mailto:secretary.general@nocalbania.org.al) <https://nocalbania.org.al>

### Kualifikimet dhe Eksperienca:

- Diplomuar në Fakultetin Ekonomik, Dega Financë- Kontabilitet; Menaxhim ose Administim.
- Të ketë 10+ vite eksperiencë profesionale, prioritet do kene individët me eksperiencë të mëparshme në audit dhe financë.
- Njohuri shumë të mira të gjuhës angleze.
- Njohje shumë e mirë e paketës Microsoft Office, Financa 5, Alpha etj.

### Aftësi dhe kompetenca kryesore:

- Të ketë aftësi të mira komunikuese;
- Të ketë aftësi të mira analitike, saktësi në kryerjen e detyrave;
- Njohuri mbi programet e ndryshme financiare;
- I/E aftë të punojë në mënyrë të pavarur;
- Etikë pune dhe përpikmëri.

### Procedura e aplikimit

Kandidatët e interesuar duhet të dorëzojnë dokumentat e aplikimit si më poshtë:

- Curriculum vitae (CV);
- Letër Interesi;
- Fotokopje të diplomave universitare;
- Dokumente të tjera mbështetëse (çertifikata të fituara nga trajnime, pjesëmarrje në konferenca, botime, letra reference, etj).

Kandidatët e interesuar duhet t'i dërgojnë dokumentet e aplikimit deri më datë **16 Shtator 2022, ora 16.00**, në adresën [secretary.general@nocalbania.org.al](mailto:secretary.general@nocalbania.org.al), me subjekt: **"Aplikim për pozicionin Drejtor/e Finance KOKSH"**.

